



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

**1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve: **Vangjush Dako**, i akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” e kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 248 dhe 25 i Kodit Penal 2 (dy) herë, **Fiqiri Farruku, Fatmir Ejupi dhe Adrian Bulku**, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Falsifikimit të vulave, stampave dhe formularëve*” e kryer në formën e falsifikimit të formularëve të miratuar nga personi që ka për detyrë hartimin e tyre dhe në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 190/3 dhe 25 të Kodit Penal”.

**2.** Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Elsa Ulliri, me vendimin Nr. **70**, datë **25.11.2024** vendosi:

- 1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Vangjush Dako** për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 i K.Penal për faktin penal të ndërtimit të pallatit të ndërtuar nga shoqëria “Fakle” sh.p.k. dhe dënimin e tij me 2 vite e 9 muaj burgim.
- 2.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Vangjush Dako** për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 i K.Penal për faktin penal të projekt zbatimit të promenadës bregdetare dhe dënimin e tij me 2 vite e 4 muaj burgim.
- 3.** Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve, i pandehuri Vangjush Dako dënohet me 4 vite burgim.
- 4.** Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Vangjush Dako** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 vite e 8 muaj burgim.
- 5.** Vuajtja e dënimit fillon nga momenti i ekzekutimit të vendimit dhe do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, ku në përllogaritje do të mbahet në konsideratë fakti që i pandehuri nga data 06.06.2023-27.02.2024 ka qenë me masë sigurimi “Arresti në burg” dhe nga data 27.02.2024 vijon të jetë me masë sigurimi “Arresti në shtëpi”.
- 6.** Në aplikim të nenit 35/1 të K.Penal të pandehurit Vangjush Dako i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vitesh.

7. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fiqiri Farruku** për kryerjen e veprës penale *“Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”*, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 190/3-25 i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 vite burgim.
8. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Fiqiri Farruku** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 vite burgim.
9. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi, duke e vënë në provë të pandehurin, për një periudhë kohe **sa dyfishi i pjesës së mbetur të dënimit**, me kusht që gjatë kësaj kohe, i pandehuri të mos kryejë asnjë veprë tjetër penale si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.
10. Në bazë të nenit 389 të K.Pr.Penale deklarohet shuarja e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhe caktuar ndaj të pandehurit **Fiqiri Farruku** me anë të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
11. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatmir Ejupi** për kryerjen e veprës penale *“Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”*, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 190/3-25 i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 vite burgim.
12. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Fatmir Ejupi** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 vite burgim.
13. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi, duke e vënë në provë të pandehurin, për një periudhë kohe **prej 4 vitesh**, me kusht që gjatë kësaj kohe, i pandehuri të mos kryejë asnjë veprë tjetër penale si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.
14. Në bazë të nenit 389 të K.Pr.Penale deklarohet heqja e masës së sigurimit “Garancia pasurore”, parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale dhe caktuar ndaj të pandehurit **Fatmir Ejupi** me anë të vendimit Nr.63, datë 20.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
15. Në aplikim të nenit 35/1 të K.Penal të pandehurit **Fatmir Ejupi** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vitesh.
16. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Adrian Bulku** për kryerjen e veprës penale *“Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”*, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 190/3-25 i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 vite burgim.
17. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Adrian Bulku** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 vite burgim.
18. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi, duke e vënë në provë të pandehurin, për një periudhë kohe **sa dyfishi i pjesës së mbetur të dënimit**, me kusht që gjatë kësaj kohe, i pandehuri të mos kryejë asnjë veprë tjetër penale si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.
19. Në bazë të nenit 389 të K.Pr.Penale deklarohet heqja e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe caktuar ndaj të pandehurit **Adrian Bulku** me anë të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
20. Në bazë të nenit 391 të K.Pr.Penale dokumentet e bashkuara në cilësinë e provës

materiale, konkretisht akt kontroll piketim strukture i datës 05.11.2014 në formatin A3, akt kontroll piketim kuota 0+00 i datës 27.11.2014 në formatin A3, të përshkruara në pikën 16 të procesverbalit të sekuestrimit, plani i sistemimeve të jashtme të formatit A3 pa datë, akti i kontrollit të përfundimit të sistemit të jashtëm të sheshit të ndërtimit në formatin A4 i datës 10.02.2015, përshkruar në pikën 15 të procesverbalit të sekuestrimit, akt kontroll i përfundimit të karabinasë i datës 10.02.2015 në formatin A4, dy fletë përshkruar në pikën 15 të procesverbalit të sekuestrimit, deklarohen të falsifikuara.

- 21.** Në bazë të nenit 190/1/c të K.Pr.Penale provat materiale të bashkëngjitura me fashikullin e gjykimit, 4 DVD që kanë cilësinë e provës materiale të asgjeshen pasi vendimi të marrë formë të prerë.
- 22.** Shpenzimet proceduriale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurve në mënyrë solidare.
- 23.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim nga prokurori dhe i pandehuri në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

**Tiranë, më datë 25.11.2024**

**Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**